



2022

Buxheti

Një vështrim për qytetarët

Ky material mbështetet në Projektligjin për Buxhetin e Vitit 2022 të propozuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në nëntor 2021. Ky material paraqet një variant të përmbledhur dhe jo shterues të propozimit të buxhetit 2022.

Përdorimi i tekstit

Përdorimi i tekstit dhe të dhënave të paraqitura në këtë material, me kusht që të referohen pandryshim, lejohet me citimin e burimit:

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë Modifikimi i tekstit

Në rast se teksti, të dhënat apo grafikët e paraqitur këtu përdoren për të gjeneruar material apo të dhëna të ndryshme, preferohet citimi:

Bazohet në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë Informacione të tjera Projektligji I plotë për Buxhetin 2022 dhe tabelat përkatëse janë botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:

www.financa.gov.al

Për informacione apo sqarime të nevojshme mund të drejtoheni në adresën:

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit Ministria e Financave dhe Ekonomisë Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë

e-mail:konsultimepba@financa.gov.al

Paraqitja grafike nga Grid Cartels.

Botimi i këtij dokumenti u mundësua me mbështetjen e Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore (UNWomen) në kuadër të projektit rajonal "Financim Transformues për Barazinë Gjinore, për një qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe të përgjegjshme në Ballkanin Perëndimor" financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Pikëpamjet e shprehura në këtë publikimin nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet e UN Women ose të donatorit të projektit.

Përmbajtja

Mesazh për lexuesin	4
Buxheti I rimëkëmbjes ekonomike	6
Prioritetet e buxhetit 2022	
Tregues positive makroekonomikë	8
Konsolidimi i shërbimeve publike themelore	10
Bujqësia dhe zhvillimi rural	11
Shëndetësia	12
Arsimi	14
Paketa sociale	16
Drejtësia dhe rendi	18
Nxësim zhvillimin ekonomik dhe mbështesim rajonet	20
Rindërtojmë Shqipërinë	21
Nga vijnë paratë e buxhetit?	24
Ku shkojnë paratë e buxhetit të shtetit?	25

Mesazh për lexuesin



Zj. Delina Ibrahimaj
Ministre e Financave
dhe Ekonomisë

Të nderuar qytetarë,

Me anë të këtij materiali dëshiroj t'ju prezantojnë mënyrë të thjeshtuar me propozimin e buxhetit të shtetit për vitin 2022.

Buxheti 2022 synon rimëkëmbjen ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore: tërmetit të 26 Nëntorit 2019 dhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe uljen e sigurt të borxhit publik në periudhën afatmesme.

Projektbuxheti 2022 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Pas recesionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në -4%, ekonomia pritet të rikuperohet ndjeshëm në vitin 2021.

Sipas vlerësimeve më të fundit, rritja ekonomike gjatë vitit 2021 parashikohet në 7.6%, duke vijuar këtë trend pozitiv edhe në periudhën afatmesme 2022-2024, me një mesatare prej 4%.

Rritja ekonomike dhe punësimi do të mbështeten edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike prej 6.4% e PBB-së.

Në projektbuxhetin e vitit 2022, **programimi i të ardhurave buxhetore**, mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhin publik. Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe uljen e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rimëkëmbjen ekonomike,

Qeveria shqiptare, nëpërmjet Buxhetit 2022 synon jo vetëm konsolidimin e financave publike, por edhe të adresojë reduktimin e pabarazive gjinore në sektorë si: mbrojtja sociale, arsimi, shëndetësia, bujqësia, etj.

si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2022-2024 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike, duke u përqendruar në procesin e rindërtimit, si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve kombëtare, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet dhe kujdesit ndaj brezave, duke filluar me programet specifike për mirërritjen dhe shkollimin e fëmijëve, aftësimin dhe punësimin

e të rinjve, si dhe një mbështetje më të madhe financiare për shtresat në nevojë dhe moshën e tretë.

Buxheti 2022, i përgjigjshëm ndaj nevojave të burrave dhe gravesynon avancimin e përpjekjeve evropiane për barazi gjinore, nëpërmjet planifikimit të fondeve, të cilat adresojnë problematika të pabarazisë gjinore në sektorë si: shëndetësia, mbrojtja sociale, arsimi, bujqësia, etj.

Politikat sociale mbeten sërish në vëmendjen e qeverisë në këtë buxhet, duke rritur shkallën e mbulimit me kontributet e pensioneve, si dhe me mbështetjen për familjet,

burrat dhe gratë, me politikën e shpërblimit për çdo lindje.

Do të vijojë financimi i ngritjes së shërbimeve shoqërore për burrat dhe gratë me aftësi të kufizuar dhe gjithë burrat e gratë, familjet në nevojë, krahas skemave të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e aksesit, thjeshtimi i procedurave administrative për sipërmarrjen dhe qytetarët, rritja e mirëqenies, ulja e borxhit publik dhe mirëmenaxhimi i financave publike përbëjnë platformën e garantuar nga ky buxhet, mbi të cilën mbështetet aspirata evropiane e qytetarëve shqiptarë.

Buxheti i rimëkëmbjes ekonomike dhe konsolidimit fiskal

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 synon arritjen e objektivave të Qeverisë për konsolidimin e mëtejshëm të rimëkëmbjes ekonomike.



Shtyllat kryesore për përmirësimin e jetesës së burrave, grave dhe fëmijëve do të jenë arsimi, shëndetësia, mbështetja e burrave dhe grave më në nevojë, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional të të rinjve dhe të rejave, mbështetja pro-aktive ndaj biznesit, mbështetja e grave dhe burrave të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore të dy viteve të fundit.

Prioritetet e buxhetit 2022

Arsimi

Arsimi do të vijojë të finanohet me 3% të PBB dhe prioritet do të jetë ofrimi i teksteve shkollore falas për nxënësit që ndjekin arsimin bazë, si dhe për ata që janë në nevojë dhe ndjekin arsimin e mesëm.

Shëndetësia

Shëndetësia, do të finanohet me mbi 3% të PBB-së, mesatarisht për periudhën 2022-2024. Përveç rritjes së pagave me 6% për rreth 18,500 mjekë dhe infermierë prej datës 1 korrik 2022, do të finanohen edhe politika të tjera prioritare të cilat do të fokusohen në zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Mbrojtja Sociale do finanohet me rreth 9.9% të PBB-së në vitin 2022, duke ofruar ndër të tjera dyfishim të ndihmës ekonomike për 15 mijë familje me tre ose më shumë fëmijë nën 18 vjeç si dhe trefishim të kësaj ndihme për gratë e dhunuara apo viktime të trafikimit dhe fëmijët jetimë nën 18 vjeç.

Mbrojtja Sociale

Fermerët

Fermerët, do të përfitojnë rreth 7.1 miliardë lekë financime nëpërmjet skemave të ndryshme, që synojnë zgjerimin e aktiviteteve të tyre prodhuese bujqësore, blegtorale dhe rritjen e eksporteve.

Në projektbuxhetin e vitit 2022 parashikohen 20 miliardë lekë për përballimin e procesit të rindërtimit nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, duke synuar përfundimin e tij brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm.

Rindërtimi

Tregues pozitivë makroekonomikë

RRITJA REALE

4,1%

ePBB-së

PRODIMI I BRENDSHËM BRUTO (PBB)

1867,4

miliardëlekë

INFLACIONI

2,8%

ePBB-së

Perspektiva ekonomike

Rritja ekonomike parashikohet të jetë 4.1 % në vitin 2022 dhe pritet të mbetet në të njëjtat nivele rreth 4% përgjatë periudhës afatmesme e në vijim.

Më poshtë një krahasim edhe me mesataren e rajonit në terma të rritjes reale ekonomike:

Tabela 1: Produkti i Brendshëm Bruto (rritja vjetore në %, në terma realë)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
<i>Rritja reale ekonomike, në %</i>						
Shqipëria	3.3	3.8	4.1	2.2	-4.0	7.2
Bosnja dhe Hercegovina	3.1	3.2	3.7	2.8	-3.2	4.0
Kosova	5.6	4.8	3.4	4.8	-5.3	7.1
Maqedonia	2.8	1.1	2.9	3.2	-4.5	4.6
Mal i Zi	2.9	4.7	5.1	4.1	-15.3	10.8
Serbia	3.3	2.0	4.4	4.3	-0.9	6.0
Mesatarja e rajonit	3.4	2.7	4.0	3.6	-3.1	5.9

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2021

Parashikimi I PBB-së nominale sipas MFE është 1867,4 miliardë lekë kurse ai I FMN-së 0,2 miliardë lekë më pak.

	2019	2020	2021	2022	2023	2024
MFE	1691,7	1617,5	1769,3	1867,4	1964,8	2070,9
FMN	1691,7	1617,5	1769,3	1867,5	1964,9	2071,0
Diferenca MFE-FMN	0,0	0,0	0,0	(0.20)	(0.20)	(0.10)

Kemi një rritje të PPB/frymë (në mijë lekë) nga viti 2021 nga 624,800 ALL në 661,100 ALL në 2022. Kjo rritje parashikohet të vijojë dhe në periudhën në vijim.

	2021	2022	2023	2024
PPB/banor(në mijë lekë)	624,8	661,1	697,5	737,5

Rritja e punësimit

Norma e papunësisë së burrave dhe grave në Shqipëri parashikohet me ulje nga 11,4% në 2021 në nivelin 10,3% në 2022.

	2017	2018	2019	2020	T1-2021
Shqipëria	14.1	13.0	12.9	12.0	12.0
Bosnia dhe Hercegovina	20.5	18.4	15.7	15.9	n.a
Kosova	30.5	29.6	25.7	26.0	n.a
Maqedonia e Veriut	22.4	20.7	17.3	16.4	16.0
Mal i Zi	16.4	15.5	15.4	18.4	n.a
Serbia	13.5	12.7	10.4	9.0	12.8
Mesatarja e rajonit	19.6	18.3	16.2	16.3	n.a

Investimet publike parashikohen në vlerën 119.1 miliardë lekë ose 6,4% të PBB-së, ku përfshihen edhe fondi i rindërtimit në shumën 20 miliardë lekë si dhe transferta kapitale për fondin e shpronësimeve me 1,8 miliardë lekë.

Deficiti buxhetor për vitin 2022 planifikohet të jetë në nivelin 5,4 % të PBB dhe borxhi public do të arrijë vlerën e 78.6% të PBB.

	2016	2017	2018	2019	2020	2021*
<i>Borxhi publik dhe i garantuar (në % ndaj PBB)</i>						
Shqipëria	72.3	71.9	69.5	67.4	77.2	78.6
Bosnja dhe Hercegovina	43.8	37.7	35.6	34.5	38.8	38.0
Kosova	14.5	16.4	17.0	17.6	22.4	23.2
Maqedonia	48.8	47.7	48.4	49.4	60.2	62.7
Mal i Zi	70.4	69.1	74.1	80.0	108.7	90.7
Serbia	68.6	58.7	54.4	52.7	57.8	60.3
Mesatarja e rajonit	53.1	50.2	49.8	50.3	60.9	58.9

Burimi: Banka Botërore, RER - Vjeshtë 2021

1 DIGJITALIZIMI SHËRBIMEVE PUBLIKE THEMELORE



Rrisim konsiderueshëm numrin e shërbimeve të digjitalizuara të ofruara për qytetarët nëpërmjet portalit e-Albania, duke ulur ndjeshëm kostot dhe kohën e shpenzuar për ato.

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL / 0.7% ndaj PBB

Të ndihmojmë dhe kujdesemi për fshatin



Sa hektarë do të rehabilitohet sistemi i vaditjes?

35 mijë hektarë është rritja vjetore e sipërfaqes ujitëse me infrastrukturë kryesore të përmirësuar/mirëmbajtur (si proces ciklik vjetor).

Sa hektarë do të rehabilitohet sistemi i kullimit?

45 mijë hektarë është sipërfaqja kulluese me rrjetin kryesorë kullues të pastruar.

Si do të rritet siguria ushqimore?

Do të vaksinohen **930 mijë kafshë**

Sa fermerë do të përfitojnë naftë pa taksë?

17,500 përfitues pritet të ketë nga Skema e Subvencionit të naftës për bujqësinë.

Sa fermerë do të përfitojnë mbështetje të drejtpërdrejtë buxhetore?

4,800 përfitues pritet të jetë numri i përfituesve total të mbështetur nga Skemat Kombëtare, nga të cilët 720 do të jenë gra.

Si do të përmirësohet performanca e sektorit të zhvillimit rural?

Duke shtuar numrin e të punësuarve në bujqësi dhe agro përpunim deri në 533,466.

Jetesë e shëndetshme edhe në kohë pandemie



Duke vijuar luftën me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, buxheti 2022 do të mbështesë me politika mbulimin universal me shërbim cilësor, diagnostikimin dhe parandalimin e hershëm të sëmundjeve, si dhe shtimin e games së medikamenteve të rimbursueshme. Më shumë investime në infrastrukturën shëndetësore, për të siguruar akses në shërbime themelore.

Jetesë e shëndetshme për fëmijët, gratë dhe burrat e të gjitha moshave

- Shërbimi i kontrollit bazë falas për 475 mijë
- Pacientë në vit, 232,000 burra e 243000 gra
- Mbi 36% më shumë gra mbi 35 vjeç që përfitojnë nga shërbimet falas për depistimin e kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës së mitrës, me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.9/100000 në vitin 2021 në 2.7/100 000 në vitin 2023.
- Financimi i Vaksinës COVID-19 në vitin 2022 me vlerën 2.7 miliardë lekë, për të siguruar vaksinimin e plotë të të gjitha grupmoshave të parashikuara.

- Financim i shpenzimeve për funksionimin e Spitalit Rajonal Memorial të Fierit me 750 milionë çdo vit;
- Rimbursimi i barnave dhe prezantimi i paketave të reja të syve dhe e kujdesit oral për fëmijët me një shtesë 600 milionë lekë.
- Rikonstruksion i godinës së vjetër të Neonatologjisë dhe Obstetrikës dhe ndërtimi i dy godinave të reja në SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë" me qëllim shtimin e kapaciteteve dhe numrin e pacientëve gra dhe fëmijë të sapolindur që trajtohen në spitalet shtetërore nga 38,500 në 2021 në 39,816 në 2022.

475 MIJË

kanë përfituar shërbimin e kontrollit bazë falas

Rritja e numrit të pacientëve burra dhe gra të trajtuar:

- 8,600 pacientë burra dhe gra më shumë, të cilët përfitojnë nga paketat e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë
- 26.000 burra dhe gra të trajtuar me radioterapi,
- 234.000 burra dhe gra të trajtuar me dializë
- 26 burra dhe gra përfitues të mundshëm të transplantëve renale
- Trajtimi I mesatarisht i 25

fëmijëve në vit djem dhe vajza me Sindromën Down

- Ulja e nivelit aktual prej 15% të pacientëve burra dhe gra të rishtruar për të njëjtën diagnose Brenda 72
- Infrastrukturë shëndetësore më e mire në çdo skaj të vendit:
- Rritja e numrit të thirrjeve të adresuara në njësitë e Urgjencës mjekësore, reduktimin e kohës së përgjigjes në 4.5 minuta dhe rritjen e numrit të jetëve të shpëtuar.

Objektivat për vitin 2022

Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve si dhe shërbimi i kontrollit bazë falas për 475 mijë pacientë në vit

Trajtimi me recetë rimbursimi për mbi 400 mijë pacientë

Ulja e kohës së përgjigjes ndaj thirrjeve të adresuara në njësitë e Urgjencës mjekësore dhe rritja e numrit të jetëve të shpëtuar





Arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor

Buxheti 2022 I jep vëmendje të veçantë kërkesës në rritje për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për zhvillim të hershëm të tyre, ofrimin të teksteve shkollore falas për 236.000 nxënës që ndjekin arsimin bazë, si dhe tekste shkollore falas për nxënësit nga shtresa sociale në nevojë në arsimin e mesëm dhe të lartë; sigurimin e transportit për nxënësit në zonat rurale, rritjen e pagave me 6% të parashikuar për rreth 36 mijë mësues të ciklit parauniversitar.

□ Mbështetje për familjet në nevojë me sigurimin e transportit për nxënësit dhe mësuesit, programe të veçanta si ai i shkollave komunitare dhe kujdes për fëmijët me nevoja të veçanta, nëpërmjet aksesit më të mirë dhe rritjes së numrit të mësuesve ndihmës. Për vitin 2022 e në vijim janë alokuar 250 milionë lekë shtesë, me qëllim sigurimin e shërbimit të transportit, si dhe mbulimin e shpenzimeve të transportit të 32-35 mijë nxënësve, të cilët kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km larg nga shkolla, si dhe

transportin për rreth 12 mijë mësues, të cilët punojnë mbi 5/Km larg nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë.

- Mbi 20% nxënës, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm (16,500 nxënës) do të përfitojnë tekste shkollore falas.
- Rritja e numrit të nxënësve , të cilët ndjekin arsimin e mesëm profesional nga 17.5% ndaj totalit të nxënësve në ciklin arsimor të mesëm publik në vitin 2022 në 18.2% në vitin 2024; rritja e përqindjes së

nxënësve të punësuar pas mbarimit të ciklit të arsimit të mesëm profesional nga 45% e totalit në vitin 2022 në 47% në vitin 2024.

- 1.9 miliardë lekë shpenzime kapitale për arsimin parauniversitar (cikli bazë dhe i mesëm) do të riorientohen për projekte që fokusohen më tepër në krijimin e laboratorëve shkencorë si dhe klasave për IT.
- 700 milionë lekë për projektet twining për Universitetet.



Nxënie gjithë përfshirëse dhe cilësore në arsimin para universitar

- 1,300-1,400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë me kuota ushqimore;
- Rritje e numrit të vajzave që regjistrohen në arsimin e mesëm të lartë publik, pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm
- Edukimin nëpërmjet sportit në shkolla, për përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për të rinjtë vajza dhe djem
- Uljen e madhësisë së grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.

Arsimi i mesëm profesional

- Rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale
- Rritja e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale,
- Rritja e numrit, të cilët vijnë nga zonat rurale dhe ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale
- Rritja e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale
- Rritja e numrit të nxënësve, të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale.

Objektivat për vitin 2022

Transport i 32-305 mijë vajzave dhe djemve që jetojnë mbi 2 km larg nga shkolla

Ofrimi i teksteve shkollore falas për rreth 236 mijë vajza dhe djem

Rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit

Mbrojtje sociale për çdo individ në nevojë



Buxheti 2022 ofron një mbështetje të veçantë për gratë dhe vajzat e dhunura, viktimat të trafikimit; familjeve me mbi 3 fëmijë nën moshën 18 vjeç; vajzave dhe djemve me status jetim; burrave dhe grave nga grupet vulnerable

Programet e riintegrit social do të synojnë mbështetjen e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale. Mbështetje për punësim dhe shërbime sociale.

- Skema e re e vlerësimit dhe programe të ri-integrimit social mbështesin rreth 68,000 familje dhe burra e gra në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, nga ku mbi 12% e përfituesve janë gra kryefamiljare
- Numri i burrave dhe grave me aftësi të kufizuar si dhe kujdestarëve të tyre do të rritet nga 163 mijë në 167 mijë, 45% e të cilëve janë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara apo kujdestarë të tyre
- Rritjen mbi 95% të numrit të përfituesve burra e gra të varfër që marrin në mbi totalin e

aplikuesve.

- Rritja mbi 60% e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të riintegruara pas trajtimit në institucionet e kujdesit social.

Rritja e ndihmës ekonomike me rreth 1.45 miliardë lekë në vitin 2022 ku përfshihen:

- Rritjen me 10% të masës së ndihmës ekonomike për rreth 50 mijë familje që përfitojnë këtë ndihmë;
- Dyfishimin e ndihmës ekonomike për familjet me 3 ose më shumë fëmijë, ku përfitojnë rreth 15 mijë familje.
- Trefishimin e ndihmës ekonomike për 675 gra të dhunura dhe trafikuar dhe 670 fëmijë jetim nën 18 vjeç.

Mbështetje familje të reja dhe burrat e gratë në nevojë:

- Shpërblimi në lindje: 2.3 miliardë

lekë për shpërblimin për çdo lindje, për të mbështetur rreth 30 mijë familje/prindër burra dhe gra, në vit;

- Pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar: 21.6 miliardë lekë në vit;
- Pagesat e papunësisë dhe mbështetje për punësim: mbi 1 miliardë lekë në vit;
- 1 miliard lekë për ish të përndjekur burra dhe gra;

Objektivat për vitin 2022

- Rritjen mbi 95% të numrit të përfituesve të varfër që marrin në mbi totalin e aplikuesve.
- 2.3 miliardë lekë për shpërblimin për çdo lindje, për të mbështetur rreth 30 mijë familje
- Pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar: 21.6 miliardë lekë në vit

Jetesë e sigurt, drejtësi dhe barazi ligjore për të gjithë

Buxheti për vitin 2022 vijon të ketë prioritet vazhdimin e Reformës në Drejtësi; jetësimin e saj në dobi të mbrojtjes së të miturve, forcimin e luftës kundër korrupsionit në administratë; garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe sigurimin e ri-integrimit të tyre në shoqëri edhe nëpërmjet rritjes së performances në shërbimin e provës.

Garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, janë prioritetet e parveprimtarinë e Policisë së Shtetit, duke përmirësuar kontrollin e territorit dhe sigurinë në komunitet, parandalimin dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore, në funksion të një kontrolli më efektiv dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

Drejtësi për ish-pronarët burra dhe gra dhe zgjidhje e problemeve sociale

- Realizimi i skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 1000 që është aktualisht në 1,600 në 2023;
- Ndarja e fondit të vënë në dispozicion kundrejt subjekteve që kanë përfituar të drejtën e kompensimit duke bërë që të rritet numri i subjekteve të kompensuara nga viti në vit.

Përmirësimi i Sistemit të Burgjeve

- Norma e recidivitetit (burra) të

ketë një trend constant 18% ndërvite;

- Norma e recidivitetit (gra) të ketë një trend rënës nga 1% që është aktualisht;
- Të dënuar që punësohen pasi fitojnë lirinë të rritet nga 10% e totalit që është aktualisht.

Vëmendje për gratë dhe familjet

- Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje nga 16 minuta në 2021 në 14 minuta në 2022
- Rritja e numrit të masave të menjëhershme mbrojtëse për grate dhe vajzat e dhunuara në masën 2% nga 2021, nga 2,700 në 2,750

Siguri në rrugë dhe shërbim policor miqësor

- Përmirësimi i sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të burrave e grave, sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë në masën 7% çdo vit, nga 1,406 raste në

vitin 2021 në 1,320 raste në 2022;

- Rritjes së nivelit të sigurisë publike, duke forcuar kontrollin e territorit dhe sigurinë në komunitet përmes rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit;
- Reduktimi i kohës së reagimit të shërbimeve policore (nga 17 minuta në vitin 2021 në 15 minuta në vitin 2022).
- Shtimin e numrit të grave dhe vajzave të diplomuara në Akademinë e Policisë deri në 41% ndaj totalit në vitin 2022, me qëllim realizimin e barazisë gjinore edhe në forcat e Policisë;

Objektivat për vitin 2022

- Rritja e numrit të masave të menjëhershme mbrojtëse për grate dhe vajzat e dhunuara në masën 2%
- Reduktimi i kohës së reagimit të shërbimeve policore deri në 15 minuta
- Rritjes së nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe sigurinë në komunitet

2 Mbështesim biznesin për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm / 3.3% ndaj PBB



Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve "Made in Albania"; Rritja e përpjekjeve për të reduktuar informalitetin e ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si pengesë kyçe në aksesin e financimeve të SME-ve, nëpërmjet:

- Rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare

në tregun ndërkombëtar nëpërmjet granteve nga Fondi I Konkurrueshmërisë.

- Avancimit të mëtejshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit nëpërmjet granteve që l akordohen bizneseve të specializuara në këtë fushë nga Fondi i Inovacionit.
- Mbështetjes së sipërmarrjeve të sektorit të artizanatit dhe zejtarisë me qëllim konsolidimin e tyre në treg dhe rritjen e numrit të të punësuarve nëpërmjet

"Fondit në mbështetje të biznesit kreativ".

Projekti i mbështetjes së bizneseve Start-Up në shumën 250 milionë lekë për çdo vit;
Projekti i AIC me 200 milionë lekë për vitin 2022;
Pagesa e papunësisë për pagesën e naftëtarëve me një kosto vjetore indikative 300 milionë lekë;
Garancia Sovrane 1 miliardë lekë për Manufakturën dhe Sipërmarrjen.

Shqipëria e rindërtuar dhe e rimëkëmbur pas fatkeqësive natyrore



20 miliardë lekë për të përmbyllur procesin e rindërtimit.

Procesi i Rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi që do të vijojë të zbatohet me sukses edhe për gjatë vitit 2022.

Në projektbuxhetin e vitit 2022

parashikohen 20 miliardë lekë për përballimin e procesit të rindërtimit nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, duke synuar përfundimin e tij brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm.

Për vitin 2022 dhe 2023 do të alokohen 2.7 miliardë lekë për blerjen e vaksinave anti-COVID dhe 2 miliardë lekë shpenzime të tjerapër përballimin e situatës së krijuar prej COVID-19.



Transporti dhe akses

- 3,483 km rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitin 2022 në të gjithë territorin;
- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë burrash dhe grash, djem dhe vajzash dhe numri i pikave të zeza me 23%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit;
- Përfundimi i punimeve në rrugën Kardhiq – Delvinë;
- Rruga e Arbrit;
- Ndërtimi Tuneli i Llogarasë;
- Ndërtimi i segmentit rrugor Palasë – Dhërmi;
- Segmenti i Unazës së Jashtme të Tiranës;
- Ndërtim By Pass perëndimor Shkodër;
- Zgjerim i segmentit dalje Elbasan – Prrenjas – Qafë Thanë;
- Mirëmbajtja e rrugëve nacionale me financim të brendshëm do të përfitojë një rritje prej 1 miliardë lekë, duke mbajtur rreth 3.1 miliardë lekë në total për mirëmbajtjen e rrugëve duke përfshirë dhe financimet e projektit të Bankës Botërore për mirëmbajtjen e sigurinë rrugore;
- Për hekurudhat (1.7 miliardë lekë), kryesisht për krijimin e linjave të reja hekurudhore Tiranë-Durrës dhe Tiranë-Rinas;
- Për Portet ku theksohen PPP për Portet e Durrësit dhe të Vlorës;
- Për Aeroportet ku do të ndërtohet Aeroporti i Vlorës dhe ai i Sarandës;

3483_{KM}


rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitin 2022 në të gjithë territorin;

1,7_{MILIARDË}

lekë për hekurudhën Tiranë-Durrës dhe Tiranë – Rinas

3,1_{MILIARDË}

lekë për mirëmbajtja e rrjetit kombëtar të rrugëve nga buxheti dhe Banka Botërore



Ujë për burrat dhe gratë

Reforma në sektorin e ujit vijon të jetë një nga prioritetet e Qeverisë. Ajo mbështetet në reformimin e mirëqeverisjes dhe orientimin e investimeve drejt performancës, si dhe drejt sigurimit të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë, duke sjellë kështu një përmirësim të ndjeshëm dhe të shumë pritur të jetesës, sidomos në zonat rurale:

- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar nga 12.1 orë në vitin 2013 në 20.5 orë në vitin 2023.

(për vitin 2021 18.1 orë)

- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat urbane nga 11 orë në vitin 2013 në 23.1 orë në vitin 2023. (për vitin 2021 21.5 orë)
- % e mbulimit të popullatës me ujëmatës duke shmangur kështu faturimin aforfe nga 59.18% në vitin 2013 në 94% në vitin 2023.

Zhvillim për industrinë dhe shfrytëzimi i denjë i burimeve natyrore:

- Nxitja dhe inkurajimi i ndërtimit

të objekteve të përpunimit të mineraleve;

- Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit minerar dhe rritja e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore;
- Nxitja e interesit të biznesit vendas dhe të huaj për mundësi zhvillimi veprimtarish industriale
- Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e Lëkurë-Këpucës, industrisë së bakrit, nikel-silikateve dhe kuarciteve..

18.1 ORË

Furnizim me ujë të pijshëm në rang kombëtar për vitin 2021

21.5 ORË

Furnizim me ujë të pijshëm në zonat Urbane për vitin 2021

94%


e mbulimit të popullatës me ujëmatës në vitin 2023

Nga vijnë paratë e buxhetit të shtetit?

Në vitin 2022, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 536.8 miliardë lekë, nga këto, të ardhurat tatimore 468.6 miliardë lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat 360.5 miliardë lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen 99,7 miliardë lekë.



PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE




Ku shkojnë paratë e buxhetit të shtetit?


Shpenzimet kryesore

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2022 është planifikuar 637.7 miliardë lekë ose 34.1% e PBB.

SHPENZIMET BUXHETORE SIPAS FUNKSIONEVE TË QEVERISË (NË MILIONLEKË)



SHPENZIMET BUXHETORE SIPAS FUNKSIONEVE TË QEVERISË (NË % ndaj totalit)



Pavarësisht nivelit relativeisht të lartë që vjen si pasojë e efekteve negative të tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, deficit buxhetor vijon të mbështesë ekskluzivisht financimin e investimeve publike. Në fund të vitit 2024, niveli i deficitit buxhetor parashikohet të ulet në 2.8% të PBB, duke përmbushur objektivin madhor të Qeverisë për uljen graduale të stokut të borxhit publik



SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

